

II. SOVRANITETI

NOCIONET KRYESORE:

sovrانيتi; sovraniteti i pandashëm, i patjetërsueshëm dhe i patransportueshëm; sovraniteti i qytetarëve.

PYETJE :

- 1. Çka nënkuptojmë me sovranitetit ?**
- 2. Ku janë zanafillat e teorisë për sovranitet ?**
- 3. Çka është thelbi i konceptit të sovranitetit të popullit ?**
- 4. Si përcaktohet sovraniteti i RM në nenin 1 paragrafi 2 nga Kushtetuta e RM?**
- 5. Prej ku buron dhe kujt i takon sovraniteti sipas nenit 2 paragrafi 1 nga Kushtetuta e RM ?**
- 6. A ekziston sovranitet absolut ?**

1. Rëndësia

Sovraniteti do të thotë se ndonjë subjekt është më i lartë (kulmor), i pavarur, sovran, superior. Të gjithë në raport më të janë më të ulët dhe të varur.

Ky nocion ka përdorim të gjerë.

Megjithatë, më e rëndësishme është lidhshmëria e dukurive politike, para së gjithash për pushtetin shtetëror. Në këtë kuptim pushteti shtetëror është pushtet kulmor dhe i pakufishëm publik në territor të caktuar.

Republika e Maqedonisë në nenin 1 paragrafin 1 nga Kushtetuta është i përcaktuar si shtet sovran, i pavarur, demokratik dhe social, ndërsa në paragrafin 2 thuhet :”Sovraniteti i Republikës së Maqedonisë është i pandashëm, i patjetërsueshëm dhe i pa transferueshëm”, me çka sovraniteti përcaktohet si karakteristikë kryesore e shtetit maqedon në planin e brendëshëm (sovraniteti i brendëshëm) dhe në planin ndërkombëtar (sovraniteti i jashtëm).

2. Prejardhja dhe format

Mendimi politik merret me sovranitetin që nga themelimi i shtetit, së pari në suazat e filozofisë, ndërsa pastaj në të drejtën kushtetuese, të drejtën ndërkombëtare publike, historinë e të drejtës, sociologjinë politike, sistemit politik dhe të tjerë.

Zanafillat e teorisë për sovranitetin i gjejmë në Egjiptin e vjetër, në mileniumin e tretë p.e.s, si pjesë e mësimin të piramidave sociologjike. Në kulm është zoti, pas tij faraonët, pastaj fallxhorët, bujqit dhe skllëverit(robërit).

Në mendimin e Greqisë antike Platoni i përcaktonë filozofët për bartës të pushtetit shtetëror sovran, por më vonë këtë funksion e lidh me ligjet.

Sipas Aristotelit, pushteti sovran në shtet i takon ligjit.

Në Romën e vjetër pushteti mbretëror është pushtet më i lartë (*autocritas*). Ajo është burimore dhe e pavarur në raport me pushtetet e tjera. Në mesjetë kisha dhe shteti kanë luftuar për primat.

Feudalizmi nuk është i qëlluar për zhvillimin e teorisë së sovranitetit në pushtetin shtetëror, për atë se shteti feudal është i rrethuar me armiq të jashtëm dhe të brendëshëm.

Xhan Bodeni është teoricienti i parë në teorinë e sovranitetit. Sipas tij, vetëm monarku në të cilin është i përfytyruar pushteti i tërsishëm shtetëror është juridikisht i pakufishëm. Pushteti i tij del nga zoti dhe është i pakufizuar, i vetëm, i papërgjegjshëm, i gjithëkohshëm dhe jotransportues. Ai përbëhet nga: sjellja e ligjeve, emërimi i nëpunësve të lartë shtetëror, amnesti, tatizim, farkimi i të hollave, nënshtrimi i nështetasve.

Tomas Hobsi u takon teoricientëve të sovranitetit të monarkut.

Në shek. XVIII, veçanërisht në parambrëmjen e Revolucionit borgjez frëng, dominon ideja për sovranitetin e popullit.

Përfaqësuesi më i njohur i saj është Xhan Xhak Ruso. Teoria e sovraniteti të popullit thotë se populli është bartës i pushtetit sovran, e jo monarku. Sipas kësaj, sovraniteti është jotransportiv, i pandashëm dhe dukuri e pandashme e popullit.

Sovraniteti i popullit realizohet para së gjithash nëpërmjet formave të demokracisë direkte. Megjithatë, Rusoja, më vonë lëshon pe, ndaj disa kushteve, kryerja e sovranitetit nga ana e përfaqësuesve dhe trupave përfaqësues (pozita qendrore e kuvendit, e drejta e përgjithshme zgjedhore, zgjedhje të qinqerta, ndalimi i rizgjedhjes, dhënia instruksione përfaqësuesve dhe ngjashëm).

Sovraniteti i popullit dhe demokracia janë dy anë të një dukurie. Xhems Braje thotë se “sovraniteti i popullit është parullë e demokracisë”.

Abraham Linkoln në porosinë e Getiburskës nga viti 1863 do të thotë : Demokracia është qeverisje e popullit, nga populli dhe për popullin”.

Kuptohet, praktika e deritashme e zbatimit të sovranitetit është qeverisjes e shumicës. Qeverisja e shumicës si formë e realizimit të sovranitetit të popullit mund të jetë demokraci, vetëm nëse është e mbrojtur pakica.

Pluralizmi partiak, zgjedhjet e lira dhe të sinqerta, të drejtat dhe liritë politike të qytetarëve, mendimi i zhvilluar publik dhe opioni i institucionalizuar, janë kushte pa të cilët shumica nuk mund të jetë demokraci.

Përkundër përfshirjes së gjerë të sovranitetit në numër të madh të kushtetutave në botë, si edhe qëndrimin e konceptit tradicional të sovranitetit, e mohojnë shumë sociologë dhe politikologë (Kont), si edhe teoricientë juridike (Digi, Kelzen, Laski).

Në kushte me pluralizëm (të brendshëm dhe të jashtëm), në asociacione dhe integritime të llojeve të ndryshme, si edhe rregullimit ndërkombëtar juridik, është qartë se sovraniteti nuk është kategori absolute.

3. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë dhe sovraniteti

Sipas Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë nga viti 1991” Sovraniteti del nga qytetarët dhe u takon qytetarëve” (neni 2 paragrafi 1). Me këtë afirmohet teoria e sovranitetit të qytetarëve, për shkak së zgjedhja e pushtetit është tek individi, e jo te kolektiviteti. Paralelisht me dispozitën themelore për qytetarët, me ndryshimin e Preambulës së Kushtetutës së RM vjen në shprehje dysia e sovranitetit të qytetarëve dhe shumënacionaliteteve nëpërmjet formulimit “ qytetarët e Republikës së Maqedonisë, populli maqedon, si edhe qytetarët të cilët jetojnë në kufijtë e saj të cilët janë pjesë e popullit shqipëtar, popullit turk, popullit vllah, popullit serb, popullit rom, popullit boshnjak dhe të tjerëve...”

Bashkëjetesa si një nga qëllimet e konstituimit të republikës së Maqedonisë, gjithashtu, implikon karakter të dyfishtë të sovranitetit.

Koncepti i sovranitetit shumënacional është prezent edhe në :

- dispozitat e nenit 7 nga Kushtetuta, sipas të cilave, gjuhë zyrtare është maqedonishtja, por edhe gjuha tjetër, të cilën e flasin së paku 20% nga qytetarët, gjithashtu, është gjuhë zyrtare;
- në inagurimin e “bashkësive” (neni 8 paragrafi 2, neni 48, neni 56, neni 69 paragrafi 2, neni 77 paragrafi 1, neni 78, neni 86 paragrafi 2, neni 104 paragrafi 109 paragrafi 2, neni 114 paragrafi 5 dhe neni 131 paragrafi 4). Në fakt, bëhet fjalë për sovranitetin binacional, i shprehur nëpërmjet lidhjes së gjuhës tjetër zyrtare për qytetarët 20 %, numër i arritshëm vetëm për bashkësinë shqiptare, si edhe nëpërmjet përbërjes së Komitetit për marrëdhënie në mes të bashkësive: shtatë Maqedon dhe shtatë shqiptarë dhe nga një nga bashkësitë e tjera.